



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2818 Prot.

Lezhë, më 03 . 03 . 2022

VENDIM

Nr. 25 Datë 28 . 02 . 2022

PËR

KALIMIN E FONDIT TË MIRATUAR NGA KËSHILLI BASHKIAK ME VENDIMIN NR 177 , DATË 23.12.2021 PER BUXHETIN E VITIT 2022 , NGA KLUBI SPORTIV "BESËLIDHJA" TEK SHOQATAT SPORTIVE SIPAS KËRKESAVE TË ADMINISTRUARA NË BASHKI

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" neni 40 pika 4.Ligji 79/2017 "Për Sportin", ndryshuar me ligjin.105/2020, VKM nr 678, datë 14.11.2018, i ndryshuar me vendimin Nr. 789 datë 15.12.2021 "Për kriteret, mënyrën e shpërbllimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

- 1- Kalimin e fondit te miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendimin nr 177 datë 23.12.2021 në Programin 08130 "Sport dhe Argëtim", artikulli 602 Shpenzime operative, për vitin 2022, nga Klubi Sportiv "Besëlidhja", tek Shoqatat Sportive sipas ligjit nr 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar me ligjin nr.105/2020, neni 6 , pika 1 .
- 2- Amendimin e marrëveshjes së bashkëpunimit Nr 2103 Prot., datë 14.12.2021, mes Bashkisë Lezhë dhe Shoqatës "Tirana Eagles Basket" dhe lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Lezhë dhe " Shoqatës Kombëtare Shumësporte Lezhë" sipas kërkesës së kësaj Shoqate.
- 3- Përdorimin e fondit me vlerë **13,225,000 lekë** nga të cilat:

Shoqata "Eagle Basket"	4,000,000 lekë
Shoqata "Shoqata Kombëtare Shumësporte Lezhë"	9,225,000 lekë
- 4- Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Ur. 2818/ Prot
15.03.2022

Nr. 143/13 Prot.

Lezhë, më 11.03.2022

L e n d a : Konfirmim i pjesshëm vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijëni : KRYETARIT SË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16, pika 2, gërma b të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenin 44 (c) të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 45 të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", pikën 100 (c) të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit",

-Kthej për rishqyrtim pikat 1 dhe 3 të vendimit nr.25, datë 28.02.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për kalimin e fondit të miratuar nga këshilli bashkiak me vendimin nr.177, datë 23.12.2021 Për buxhetin e vitit 2022", nga klubi sportiv "Besëlidhja" tek shoqatat sportive sipas kërkesave të administruara në bashki", për arsye se nuk është në kompetencë të këshillit të bashkisë rishpërndarja e fondeve buxhetore të NJ.V.V, ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program por është në kompetencën e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.1049/6 prot, datë 07.01.2022 ka konfirmuar për bazueshmërinë ligjore Vendimin e Këshillit Bashkiak Lezhë nr.177, datë 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022 – 2024". Referuar VKB nr.177, datë 23.12.2021, rezulton se detajimi i fondeve buxhetore është bërë deri në nivel programi dhe zëri. Për këtë arsye miratimi i ndryshimeve brenda të njëjtit zë buxhetor (në rastin konkret art.602 i programit buxhetor 08130 "sport dhe argëtim"), mbështetur në nenin 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar është në kompetencën e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

-Konfirmoj bazueshmërinë ligjorë të pikës 2 të VKB-së nr.25, datë 28.02.2022 "Për kalimin e fondit të miratuar nga këshilli bashkiak me vendimin nr.177, datë 23.12.2021 Për buxhetin e vitit 2022", nga klubi sportiv "Besëlidhja" tek shoqatat sportive sipas kërkesave të administruara në bashki".

PREFEKTI

Gjokë JAKU

